



**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 1045/3 Prot.

Urëshen me, 26 . 03 . 2024

V E N D I M

Nr. 26 datë 18. 03. 2024

PËR

“MIRATIMIN E PLANIT TË MASAVE, PËR PARANDALIMIN DHE SHUARJEN E ZJARREVE NË PYJE DHE KULLOTA, SI DHE PËR KRIJIMIN E NJËSIVE VULLNETARE TË SHUARJES SË ZJARREVE, PËR VITIN 2024”, BASHKIA MIRDITË.

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 30, i ligjit nr. 57, datë 30.04.2020, “Për pyjet”, ligji nr. 9693, datë 19. 03. 2007 “Për fondin kulloror” të ndryshuar, VKM nr. 684, datë 02. 09. 2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 433, datë 08. 06. 2016, të Këshillit të Ministrave “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të Ish-Komunave / Bashkive”, të ndryshuar, VKM nr. 1080, datë, 22. 12. 2010 “Mbi rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota, dhe Plani i Masave nr. 1045/1, prot, datë 11.03.2024, hartuar nga sektori i monitorimit të pyjeve dhe kullota, këshilli bashkiak, pasi shqyrtoi bashkëlidhur edhe projekt-vendimin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë;

V E N D O S I:

1. Miratimin e Planit të Masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota, si dhe për krijimin e njësive vullnetare të shuarjes së zjarreve, për vitin 2024, bashkia Mirditë.
2. Plani i Masave nr.1045/1 prot, datë 11.03.2024 dhe relacioni nr. 1045 prot, datë 11.03.2024, bashkëlidhur, pjesë përbërse e këtij vendimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet bashkia Mirditë, për ndjekjen e procedurës, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 57, datë 30.04.2020, “Për pyjet”.

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor, nga Institucioni i Prefektit, të Qarkut Lezhë.

SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ

email:keshilli@bashkiamirdite.gov.al



ADRESA: SHËSHI “ABAT DOCI”, RRËSHËN

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

KRYETAR

Aleksandër PICAËU

www.bashkiamirdite.gov.al



**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 1045/Prot.
2

Rrëshen me, 11 . 03 . 2024

P/VENDIM

Nr. 37 datë 11 . 03 . 2024

“ PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MASAVE PËR PARANDALIMIN DHE SHUARJEN E ZJARREVE NË PYJE DHE KULLOTA, SI DHE PËR KRIJIMIN E NJËSIVE VULLNETARE TË SHUARJES SË ZJARREVE PËR VITIN 2024, BASHKIA MIRDITË ”

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore në nenin 30 të Ligjit me nr. 57 datë 30.04.2020 “ Për pyjet ” Ligjin nr.9693, datë 19.3.2007, “ Për fondin kullosor ”, të ndryshuar, Vendimin të Këshillit të Ministrave nr. 684 datë 02.09.2020, “ Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.433, datë 08.06.2016, të Këshillit të Ministrave “ Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave Publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish-Komunave /Bashkive ” të ndryshuar, Vendimin të Këshillit të Ministrave nr. 1080, datë 22.12.2010 “ Mbi rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota ”, Këshilli Bashkiak pasi shqyrtoi projekt-vendimin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë:

V E N D O S I:

1. Miratimin e planit të masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota, si dhe për krijimin e njësive vullnetare të shuarjes së zjarreve për vitin 2024, bashkia Mirditë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi dhe ndjekjen e procedurës, në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 57 datë 30.04.2020 “ Për pyjet ”, ngarkohet bashkia Mirditë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore ” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të qarkut Lezhë.

SEKRETARI

KRYETARI

Gaspër TOPOLLAJ

Aleksander PICA KU

Paraqitën projektin

ABU dhe A-Pyjore Drejtori
Drejtorja Juridike

Kastriot BICA
Besian DEDAJ

KRYETARI
Albert MËLYSHI



ADRESA: SHES “ABAT DOÇI”, RRËSHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe faks: (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al



BASHKIA MIRDITË
AGJENCIA E BUJQËSISE, UJITJES DHE ADMINISRTIMIT TE PYJEVE

Sektori I Monitorimit të Pyjeve dhe Kullotave

Nr. 1045 Prot

Rreshen me 11/03 /2024

RELACION

Drejtuar : KËSHILLIT BASHKIAK

“ PËR PARANDALIMIN DHE SHUARJEN E ZJARREVE NË PYJE DHE KULLOTA, SI DHE PËR KRIJIMIN E NJËSIVE VULLNETARE TË SHUARJES SË ZJARREVE PËR VITIN 2024 ”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore ”, në nenin 30 të Ligjit me nr. 57 datë 30.04.2020 “ Për pyjet ”, Ligjin nr.9693, datë 19.3.2007 , “ Për fondin kullosor ”, të ndryshuar, Vendimin të Këshillit të Ministrave nr. 684 datë 02.09.2020, “ Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.433, datë 08.06.2016, të Këshillit të Ministrave “ Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave Publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish-Komunave /Bashkive” të ndryshuar, Vendimin të Këshillit të Ministrave nr. 1080, datë 22.12.2010 “ Mbi rregullat per parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota ”, si dhe në zbatim të parashikimeve në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, për parandalimin dhe menaxhimin e situatave që mund të krijohen nga zjarret në pyje dhe kullota, Agjencia e Shërbimeve Bujqësore Veterinare dhe Pyjore harton dhe miraton tek Kryetari i Bashkise këtë plan masash.

Në këtë plan masash do gjejnë vende veprimet e domosdoshme për parandalimin e rreziqeve nga zjarri, veprimet për zbulimin e shuarjen e zjarreve dhe për rehabilitimin e sipërfaqeve të dëmtuara nga zjarri.

Bashkëngjitur me këtë relacion, gjenden për miratim plani i masave kundër zjarreve

P/ Pyjeve dhe Kullotave

Ing. Eneida Nikolli

DREJTORI

ing. Kastriot BICA



BASHKIA MIRDITË

Nr. 1007 Prot.
1

Rreshen , më 11/03 /2024

MIRATOHET

KRYETARI

Albert MELYSHI



PLAN - MASASH

Nr. _____ datë ____ / ____ /2024

“ PËR PARANDALIMIN DHE SHUARJEN E ZJARREVE NË PYJE DHE KULLOTA, SI DHE PËR KRIJIMIN E NJËSIVE VULLNETARE TË SHUARJES SË ZJARREVE PËR VITIN 2024 ”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore ”, në nenin 30 të Ligjit me nr. 57 datë 30.04.2020 “ Për pyjet ”, Ligjin nr.9693, datë 19.3.2007 , “ Për fondin kullosor ”, të ndryshuar, Vendimin të Këshillit të Ministrave nr. 684 datë 02.09.2020, “ Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.433, datë 08.06.2016, të Këshillit të Ministrave “ Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave Publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish-Komunave /Bashkive” të ndryshuar, Vendimin të Këshillit të Ministrave nr. 1080, datë 22.12.2010 “ Mbi rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota ”, si dhe në zbatim të parashikimeve në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, për parandalimin dhe menaxhimin e situatave që mund të krijohen nga zjarret në pyje dhe kullota dhe me udhëzimet e Drejtorisë së Emergjencave Civile, Agjencia e Shërbimeve Bujqësore Veterinare dhe Pyjore harton dhe miraton tek Kryetari i Bashkise këtë plan masash;

Në këtë plan masash do gjejnë vende veprimet e domosdoshme për parandalimin e rreziqeve nga zjarri, veprimet për zbulimin e shuarjen e zjarreve dhe për rehabilitimin e sipërfaqeve të dëmtuara nga zjarri, dhe konkretisht:

1. Ngritja e shtabit pranë Bashkisë Mirditë për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në pyje dhe kullota.

A.B, U. dhe Administrimit Pyjor, deri me datë 17.05.2024.



2. Organizimi i sistemit të vrojtimit - sinjalizimit, i cili funksionon gjatë gjithë vitit në shkallë të ndryshme gadishmërie, në varësi të sezonit të zjarreve, dhe në nivel njësie administrative.

A.B, U. dhe Administrimit Pyjor, në bashkëpunim me administratorët dhe kryetaret e fshatrave, deri me datë 24.05.2024.

3. Organizimi i njësive vullnetare të shuarjes së zjarreve (NJVSHZ) , me 5-15 vullnetarë, për çdo fshat të cilët veprojnë gjatë periudhës 1 maj - 15 tetor.

Njësitë administrative në bashkëpunim me kryetarët e fshatrave ,deri me datë 22.05.2024.

4. Planifikimi, shpërndarja dhe përdorimi efektiv i burimeve njerëzore e i mjeteve motorike, i fikseve të shpines, veshembathjeve të posaçme kundra zjarrit dhe veglave të punës në dispozicion dhe administrim të çdo njesie administrative.

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Tatim Taksave dhe A.B, U. dhe Administrimit Pyjor deri me datë 22.05.2024.

5. Personat përgjegjës të sektorit të pyjeve, të emergjencave civile dhe të shërbimit zjarrfikës në bashkëpunim me administratorët e njësive vendore si dhe personat përgjegjës të institucioneve të tjera, planifikojnë organizimin e takimeve për informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut, në shkolla dhe institucione të tjera shtetërore dhe private, për rrezikun e zjarreve dhe mbrojtjen nga zjarri, duke u përqendruar në;

a) Ndalimi në largësi 200 - 300 metra, e ndezjes së zjarreve në pyje e kullota ose jashtë tyre, që rrezikon djegien e pyllit ose të kullotës.

b) Ndalimin e tymosjes së bletëve në pyje e kullota, përveç kur ky veprim kryhet me mjete që kanë pajisje të posaçme dhe kapak plotësisht të mbyllur.

c) Mbajtjen nën kontroll të vizitorëve, ekskursionistëve, grupet sportive, gjatë vizitave të tyre në pyje dhe kullota, të blektoreve që shfrytëzojnë kullotat verore, si dhe të subjekteve apo individëve që punesohen në shfrytesimin e lëndës drusore dhe të prodhimeve të tjera me origjinë pyjore.

ç) Ndalimin e përdorimit të tapave të fiskekëve të gjahut prej materiali që merr zjarr lehtë (lini, letër, peceta etj).

d) Ndalimin e djegies së kashtës së të korrave të kulturave bujqësore që rrezikojnë përhapjen e zjarreve në pyje dhe kullota, pa marrjen e masave parandaluese.

dh) Ndalimin e qitjeve me predha që shkaktojnë zjarr në zonat me drurë pyjorë të thatë dhe mbeturina pyjore (gjethe, shkarpa, kalbësira etj.) e në kullota.

ë) Mbajtjen në gatishmëri të sistemit të lajmërimit dhe mjeteve të komunikimit.

f) Rendesinë e raportimit në vazhdimësi për situatën në raste zjarresh, sipas linjës së varësisë.

Specialistet përkates vazhdimisht.

6. Organizimi i provave të gadishmërisë për të verifikuar skemat e lajmërimit, grumbullimin e njerëzve, gadishmërinë e mjeteve e të sistemeve të ndërkombëtare të komunikimit.



Personi përgjegjës pranë njësise vendore dhe kryetaret e fshatrave, një prove deri me datë 14.06.2024.

7. Specialistë të shërbimit pyjor, të emergjencave civile dhe të shërbimit zjarrfikës, me mbështetjen e administratorit të njësise vendore dhe kryetarëve të fshatrave, organizojnë trajnime dhe kualifikime të punonjësve të NJVSHZ - ve, për shuarjen e zjarreve.

Përgjegjësit dhe specialistët përkatës vazhdimisht.

8. Përgatitja dhe vendosja në udhëkryqe në vende të dukshme, të tabelave të posaçme me mbi shkrime për mbrojtjen e pyjeve dhe të kullotave nga zjarri.

Specialisti përgjegjës pranë njësive administrative, deri me datë 17.05.2024.

9. Administratorët e njësive administrative dhe pronarët privatë të pyjeve ngrenë infrastrukturën për mbrojtjen nga zjarri dhe raportojnë vazhdimisht mbi mbarëvajtjen e këtij procesi në strukturat përgjegjëse të Bashkisë.

10. Shpenzimet për funksionimin dhe përmirësimin e infrastrukturës për shuarjen e zjarreve në fondin pyjor dhe kullësor, si dhe për ngritjen e njësive vullnetare të shuarjes së zjarreve (NJVSHZ) përballohen nga personat juridikë dhe/ose fizikë, që i kanë në pronësi/përdorim, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligji “ Për emergjencat civile ”.

Personat përgjegjës për financat e sektorit të pyjeve pranë bashkisë deri me datë 24.05.2024.

11. Në linjat e tensionit të lartë që kalojnë në pyje dhe kullota, krijohet një trase me gjerësi 20-30 metra, e cila pastrohet vazhdimisht nga drurët dhe mbulesa vegjetative, për të shmangur zjarret dhe aksidentet e mundshme nga defektet dhe këputjet e linjave. Punimet për hapjen dhe mirëmbajtjen e traseve bëhen në bazë të një projekti teknik, që hartohet nga specialist të licensuar të fushës dhe miratohet nga bashkia Mirdite, e cila ndjek edhe zbatimin e projektit. Shpenzimet dhe përgjegjësinë për kryerjen e këtij operacioni i ka sektori përkatës i OST-së ose administruesi i linjës.

Administratori dhe specialist përgjegjës pranë njësive administrative, vazhdimisht.

12. Në anët e rrugëve nacionale dhe rurale që kalojnë në afërsi të pyjeve, ndërmarrjet e mirëmbajtjes së rrugëve marrin masa pastrojnë skarpatet e rrugëve nga vegetacioni i djegshëm me qëllim parandalimin e zjarreve.

Personi përgjegjës për pyjet dhe personi përgjegjës për rruget rurale, vazhdimisht.

13. Djegia e kullotave të infektuara nga barërat e këqija dhe parazitët bëhet me miratimin me shkrim të Agjencisë përkatëse të shërbimit pyjor, sipas nenit 22 të ligjit nr.9693, datë 19.3.2007 , “ Për fondin kullësor ”, të ndryshuar.

Personi përgjegjës për pyjet dhe kullotat pranë njësise vendore ,vazhdimisht.

14. Ndezja e zjarreve në brendësi të zonave të mbrojtura bëhet vetëm në zona të përcaktuara nga administrata e këtyre zonave, pasi të jenë marrë masat e nevojshme për krijimin e kushteve të përshtatshme që parandalojnë përhapjen e zjarrit.

Specialist të sektorit pyjor, inspektorët e kontrollit të territorit dhe policia bashkiake, vazhdimisht.

15. Gjatë operacioneve të parandalimit e të shuarjes së zjarreve në pyje dhe kullota, në të cilat ka bërë ose objekte të tjera civile, njësitë e qeverisjes vendore, personat fizikë dhe juridikë, publikë dhe privatë dhe organet e shërbimit pyjor bashkëveprojnë me Policinë e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, duke shkëmbyer informacione dhe burime njerëzore e materiale, sipas nevojave respektive dhe mundësive reale. Në këtë kontekst kërkohet plan veprimi i përbashkët ndërmjet këtyre strukturave.

Përgjegjësi i shërbimit zjarrfikës, përgjegjësi i sektorit pyjor dhe administratorët e njesive administrative, deri me date 24.05.2024.

16. Për shuarjen e zjarreve të mëdha marrin pjesë me forca dhe mjete, sipas kapaciteteve që kanë në dispozicion, të gjitha institucionet shtetërore dhe private, njësitë e reparteve ushtarake etj. Në këto raste, shuarja e zjarrit organizohet e kryhet sipas kërkesave dhe procedurave të përcaktuara në ligjin, “ Për emergjencat civile ”, dhe në aktet nënligjore, në zbatim të tij.

17. Në rastet kur është e nevojshme vendimarrja për zgjidhjen e situatave konkrete, drejtimi organizativ dhe teknik i operacionit për shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota bëhet nga specialist i shërbimit pyjor, përgjegjës për zonën,

18. Sektori i monitorimit dhe shërbimit pyjor, specialistët përgjegjës pranë njesive administrative, shërbimet e policisë bashkiake, inspektoriati i kontrollit të territorit, dhe ato të shërbimit zjarrfikës, mbajnë kontakte të vashdueshme me strukturat e policisë pyjore dhe strukturat e tjera ligjzbatuese, ku krahas kontributit për sensibilizimin e komunitetit për marrjen e masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota, marrin të gjitha masat për zbulimin, gjetjen dhe venjen përpara përgjegjësive ligjore të personave zjarrvënës.

Specialistët përgjegjës për zonen pyjore, Shërbimit zjarrfikës, Inspektoriati i Kontrollit të Territorit, dhe Policia bashkiake - vazhdimisht.

19. Strukturat përgjegjëse të administrimit të fondit pyjor dhe kulloror pranë bashkisë hartojnë një plan - veprimi të përbashkët me strukturat e shërbimit zjarrfikës , për raste kur do të përdoren forcat zjarrfikëse dhe mjetet e tyre në operacionet izolimit dhe fikjes së zjarreve në zonat pyjore me rrezikshmëri të lartë.

Përgjegjësi i sektorit të pyjeve dhe ai i shërbimit zjarrfikës, deri me datë 13.05.2024.

20. Në buxhetin vjetor për sektorin e pyjeve dhe kullotave planifikohet një fond operativ për mbrojtjen e pyjeve dhe të kullotave nga zjarri, për:

a). organizimin dhe funksionimin e përhershëm të sistemit të analizës së të dhënave e për përcaktimin e rasteve të vendimarrjes për të ardhmen, si dhe për mbajtjen e skuadrave zjarrfikëse pranë organeve të shërbimit pyjor, dhe qeverisjes vendore.

b). Organizimin e sistemit të vrojtimit/sinjalizimit në të gjithë territorin e bashkisë Mirdite, për fushatat e sensibilizimit e të ndërgjegjësimit të publikut, për rrezikun e zjarreve në pyje dhe kullota;

c). Kryerjen e punimeve të nevojshme për parandalimin e zjarreve dhe reduktimin e pasojave të tyre (pastrime, rrallime, hapje brezash, kulla vrojtimi etj).

ç). Eliminimin e pasojave të zjarreve (hedhje fare, mbjellje, punime për frenimin e erozionit etj).



- d). Shpërblimin e të aksidentuarve në rastet e pjesëmarrjes në shuarjen e zjarreve në pyje;
- e). Dhënie e stimujve material për rastet e kontributeve të veçanta për këtë qëllim;
- ë). Përmirësimin e logjistikës me mjete e pajisje dhe të infrastrukturës mbështetëse në përgjithësi.

21. Mënyra e pagesës dhe e shpenzimeve për shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota bëhet sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, që përcaktojnë mënyrën e lëvrimit të fondeve në rastet e emergjencave civile.

Personat përgjegjës, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Tatim Taksave e bashkisë Mirditë deri me 24.05.2024.

22. Për zbatimin e këtij plan masash, ngarkohen Agjencia Bujqësisë, Ujrave dhe Administrimit Pyjor, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Tatim Taksave, Sherbimi zjarrfikës dhe njesitë administrative etj.

23. Me këtë plan masash, njihen dhe pajisen me nga një kopje të gjitha strukturat në vartësi të Bashkisë Mirditë.

P/Sek. Mont.Shërbimit Pyjorë

Ing. Eneida NIKOLLI

DREJTORI

ing.Kastriot BICA